

PARTIA E PUNES E SHQIPERISE - PPSH

TIRANE

RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TE REGJISTRUAR

Per auditimin ligjor të fondeve të përfituara dhe  
shpenzimet e kryera për fushatën zgjedhore per  
Organet e Qeverisjes Vendore

*June*

Date 21 Qershor 2015



---

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVAUUR

Drejtuar : Komisionit Qendror te Zgjedhjeve  
*Pallati i Kongreseve*

TIRANE

Subjektit Zgjedhor Partia e Punes e Shqiperise - PPSH  
Rruga e Duresit, Pallati 7, Shkalla 2, Ap. 14 ,

TIRANE

Te Nderuar Zoterinj:

Bazuar ne Ligjin 10019 date 29/12/2008 "Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise" i ndryshuar, ne zbatim te vendimit te KQZ Nr. 969 date 10/08/2015 si dhe kontraten e sherbimit Nr.7801 date 15/10/2015 te lidhur me kete institucion ne cilësinë e ekspertit kontabël të regjistruar kemi audituar pasqyrat financiare (Deklarata) bashkelidhur që lidhen me financimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushaten zgjedhore, per zgjedhjet per Organet e Qeverisjes Vendore date 21.06.2015 nga Partia e Punes e Shqiperise - PPSH .

*Pergjegjesia per Pasqyrat Financiare*

Pergatitja e pasqyrave financiare per fondet e perfituara dhe shpenzuara gjate fushates zgjedhore per organet e qeverisjes vendore date 21 Qershor 2015, eshte e subjektit Partia e Punes e Shqiperise – PPSH.

*Pergjegjesia e Audituesit*

Pergjegjesia e jone eshte qe bazuar ne auditimin e kryer, te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare. Auditimin e kemi kryer ne pajtim me Standartet Nderkombetare te Auditimit, referencë të vecantë me SNA 800. Keto standarte kerkojne qe ne te jemi ne perputhje me kerkesat e etikes dhe qe te planifikohet dhe te kryhet auditimi per te marre sigurine e arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk permbajne anomali dhe gabime materiale. Auditimi përfshin shqyrtimin, mbi bazen e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklarimet në pasqyrat financiare që përfshijnë: Librin e llogarive të subjektit, regjistrin e posaçëm të miratuar si model si dhe pasqyrën e arketim pagesave. Auditimi përfshin gjithashtu, vlersimin e parimeve të kontabilitetit të ndjekura dhe vlersimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës.

Ne çmojme se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opiniononin tone të auditimit.



Pasqyrat (Deklarata) bashkëlidhur te fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të subjektit Partia e Punës e Shqipërisë - PPSH, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21.06.2015 janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e raportimit financiar mbi bazën e arkëtimit dhe të pagesave, konform ligjit nr.9228 dt.29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

*Opinion*

Sipas opinionit tone, bazuar në auditimin e kryer, me siguri të arsyeshme, shprehim opinionin se Pasqyrat Financiare (Deklarata) e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të subjektit Partia e Punës e Shqipërisë – PPSH, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21.06.2015, japin një pamje të vertetë dhe të sinqertë.

Titullari : “ALB BB AUDITING” Shpk

Lavdimir FUSHA

  
*Lavdimir Fusha*  
Ekspert Kontabël i Regjistruar

*Liçense nr. 97, date 10.01.2001*

Tirane, 23 Nentor 2015



Adresa : Blv: "Gjergj Fishta", Nd. 16, H. 9, Ap. 20 ,  
Tirane,  
[lavdimir.fusha@albanianaudit.com](mailto:lavdimir.fusha@albanianaudit.com),  
telefon 0355 42 427 019, Mob. 069 20 67870 ;

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.  
Tirane , Nentor / 2015

Lenda : Kerkese per dergim te dhenash

Drejtuar : Partia e Punes e Shqiperise – PPSH ,  
Rruga e Durresit , Pall. 7, Shkalla 2, Ap. 14 ,

TIRANE

Me Vendim,

*Per shpalljen e rezultatit te shortit per emerimin e eksperteve kontabe te licensuar, te cilet do te kryejne auditimin e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara nga partit politike per zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te dates 21.06.2015*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ne mbledhjen e dates 10.08.2015 ,

Me ka emeruar, me cilesin e Ekspertit Kontabel te Regjistruar, te auditoj fondet e perfituara dhe te shpenzuara nga ju si subjekt zgjedhor per zgjedhjet e dates 21.06.2015.

Sipas vendimit standart te miratuar me vendim 226 date 01.06.2009 te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve , Ju duhet te paraqitni perpara ekspertit kontabel te regjistruar, rregjistrin e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara gjate zgjedhjeve te dates 21.06.2015.

Duke ju falenderuar

Eksperti Kontabel i Regjistruar

Lavdimir FUSHA

*Lavdimir Fusha*

*Lavdimir Fusha*



## PARTIA E PUNES E SHQIPERISE

Rruga "Bul.B.Curri" Pall Atacionit te rishk.11/1 Ap.74/1,Tirane – Shqiperi

Tel,+355 (4) 04 2246089 CEL:0692687581

NIPT L31817451I

Tirane,me 19.11.2015

### DEKLARATE

Deklarojme se subjekti politike ,i Partise Punes Shqiperise, nuk ka asnje te ardhur financiare as nga shteti as nga ndonje sponsor per aktivitetin e Partise.

Per zgjedhjet e pergjithshme te 13 qershorit 2013 na u akorduar nga shteti,komisjoni qendror i zgjedhjeve fondi prej 65,000 leke , i cili u perdor i teri per shtypin e P.P.SH botim i tre nr. te gazetes "8 NENTORI" dhe ku meqenese nuk morem asnje deputet,baze ligjit na u kerkua aketimi i ketij fondi prane bankes Raiffeisen, ne llogarine bankare te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve qe e beme(fotokopjen jua bashkalidhim).

Me zgjedhjet vendore te muajit qershor te vitit 2015,na eshte akorduar nje fond prej 80.000 leke(e cila nuk u ekzekutua pa u derdhur me perpara fondi prej 65.000 leke, i akorduar PPSH per zgjedhjet e pergjithshme te 13 qershorit 2013 dhe ku,sic shprehemi dhe me siper , meqenese nuk morem asnje deputet,baze ligjit na u kerkua aketimi i ketij fondi prane bankes Raiffeisen,qe e beme(fotokopjen jua bashkalidhim)

Me kontributin e anetaresise,pagim kuota Partie ka botuar gazeten "8 Nentori ",organ i kesaj Partie,ne fushaten zgjedhore ,ku ishte ne kolicion me PS.ku per keto zgjedhje vendore,u perdor edhe fondi i akorduar prej 80.000 leke per botimin e nr. te gazetes "8NENTORI" . dhe materiale te tjere propagandiste.

Partia e Punes se Shqiperise, ka kaluar ne status pasiv pasi:

-Nuk ka aktivitet dhe deklaratat mujore i deklatonte per vite me rradhe me zero,e konforme ligjit kaloj ne status pasiv.( me shume se 2 vite)



-Nuk ka te ardhura per pagese te kontributeve te sigurime shoqerore e shendetesore dhe deklaratat mujore te viteve meparshme jane deklaruar cdo muaj me zero.

-Nuk ka asnje financim ,si nga brenda dhe jashte PPSH per kontribuar ne punen e aktivitetin e PPSH.

-Pronat qe jane ne emrin e P.P.SH.si : Shtypshkronja e Poligrafikut,pasuri e PPSH

ISH /K.Q.i PPSH, ish selia e PPSH te qytetit te Tiranes,sot seli e Partise Sociliste,te gjitha kane qene e jane te Ipotekuara ne pronesi te Partise Punes Shqiperise,e s'ka shtet qe te na ktheje pronat e kesaj Partie,KEMI 25 VJET TE SHITUR E TE PLACKITUR.

Borgjezia e sotme me ne krye Partine Demokratike.ish k/ministrin Sali Ram Berisha ..gllaberon e pervetson pronat e shtetit, e bene seli te Partise Demokratike, ish shtepine qendrore te ushtrise,e bene me karrike e pa ligje pasuri popullit,e pa derdhur asnje kacille leku( sic veproje me gjithe pasurite e popullit?s'harrohet1997) e ligji nuk vepron se s'ka as shtet e as drejtesi,sic kishte kur drejtonte vendin P.P.SH per 50 vite

-Bilacet financiare jane dorezuar ne QKR e D.Tatimeve me zero,si dhe formularet mujore me zero,deri sa u miratua kalimi i PPSH ne statua Pasiv, pa aktivitet.

-Nuk ka asnje seli (qofte kjo ne pronesi ose me qera ) per aktivitetin e PPSH. Sa per dijeni,mbledhjet behen ne kafeni publike duke pire kafe se bashku me gjithe shoket qe thirren,e vijne nga gjitha rrethet e vendit, per mbledhjet e byrose apo te K.Q te PPSH

E bejme kete deklarate me kerkese te ekspertit kontabel te caktuar ,miratuar nga K.Q.Z z. \_\_\_\_\_ I ngarkuar per auditim perdorimit fondeve financiare nga Partite Politike. edhe te PPSH akorduar fond prej 80.000 leke nga K.Q i Zgjedhjeve per zgjedhjet vendore te qeshorit 2015.--Meqenese nuk e qeni ne tematike beni edhe pasurite e partive si i kane vene ne se kane sinqeritet...t'i gezojne,se ato ne bene keshtu,ne kete gjendje qe jemi sot pa pune,pa uzina e fabrika,pa minjera etj.

Financa e P.P.SH

Sekretari i Pare i Kom.Qendrore te P.P.SH

(Flutra Meta)



(Muharrem Xhafa)

